



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 22.01.2021

Nr.: 01

VENDIM

PËR

RREGULLAT PROCEDURIALE PËR PËRDORIMIN E KAMERAVE REGJISTRUESE E  
MONITORËVE (EKRA NEVE) NË VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE DHE  
TRANSMETIMIN NË KOHË REALE NGA VENDET E NUMËRIMIT TË VOTAVE NË  
AMBIENTET E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR ZGJEDHJET E  
KUVENDIT TË DATËS 25 PRILL 2021

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 22.01.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana NANO	Kryetar
Arens ÇELA	Anëtar
Dritan ÇAKA	Anëtar
Helga VUKAJ	Anëtar
Muharrem ÇAKAJ	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021



Data: 22.01.2020  
Nr. 01

Rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në VNV dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave, në KQZ

**BAZA LIGJORE:** Neni 20, paragrafi 1, shkronja “ë”, paragrafi 2, shkronja “c”, neni 22, paragrafi 2 dhe 3, neni 23, paragrafi 1, neni 94, paragrafi 4, neni 167/2 pika 6 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, paragrafi 2, shkronja “c”, nenit 22, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, nenit 23, paragrafi 1, nenit 94, paragrafi 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pasi shqyrtoi dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

### V Ë R E N:

Referuar nenit 12, paragrafi 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet.

Referuar nenit 20, paragrafi 1, shkronja “ë” e ligjit , ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

Referuar nenit 20, paragrafi 2, shkronja “c”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni Rregullator (Rregullatori) shqyrton dhe miraton projektaktet e përgatitura nga administrata e KQZ-së për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit për mbulimin e aspekteve apo procedurave të veçanta të procesit zgjedhor, ose heqjen e tyre nga përdorimi.

Referuar nenit 22, paragrafi 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ-ja ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme video monitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërimi manual i votave, në VNV-të, për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre . Nëse nuk e kryen vetë, KQZ-ja ka të drejtë të prokurojë instalimin ose edhe operimin e sistemit të video monitorimit.



Data: 22.01.2021  
Nr. 01

Rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në VNV dhe transmetimin në kohë reale nga VNV në KQZ

2

Referuar nenit 22, paragrafi 3 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përdorimi i sistemeve ose pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat për aspektet e veçanta të procesit që mbulohen nga sistemet apo pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat procedurale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të KQZ-së.

Referuar nenit 94, paragrafi 4 paragrafi 3 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë të tillë që bëjnë të mundur regjistrimin e vlerësimit të çdo flete votimi. Regjistrimi filmik video transmetohet në kohë reale në monitorë të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. Regjistrimi filmik video i procesit ruhet në media elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore. KQZ-ja ose, kur është e mundur, edhe KZAZ-ja, duhet të riprodhojë kopje të tyre dhe t’i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore kundrejt pagesës së një tarife që mbulon koston e riprodhimit.

Referuar nenit 167/2 pika 6 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Rregullatori përcakton me akt normativ tarifën e shërbimit administrativ të këqyrjes dhe çmimin e videoregjistrimit.

Për përmbushjen e detyrimeve ligjore që rrjedhin nga dispozitat sipërcituar, administrata e KQZ ka përgatitur projekt aktin për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në VNV dhe transmetimin në kohë reale nga VNV në KQZ.

### PËR KËTO ARSYE

Komisioni Rregullator, mbështetur në nenin 20, paragrafi 2, shkronja “c”, nenin 22, paragrafi 2 dhe 3, nenin 23, paragrafi 1, nenin 94, paragrafi 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### VENDOSI



Data: 22.01.2021  
Nr. 01

Rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në VNV dhe transmetimin në kohë reale nga VNV në KQZ

- 1) Të miratojë rregullat proceduriale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave, në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021 sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
- 2) Regjistrimi filmik (video) i procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinave dhe kamerat e vrojtimit në VNV të ruhet në pajisje elektronike të sigurta dhe të dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore.
- 3) Administrata e KQZ-së, ose kur është e mundur dhe KZAZ-ja, do të riprodhojë kopje të materialit të regjistruar dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë, sipas tarifave të përcaktuara sipas lidhjes 2 bashkëlidhur këtij vendimi.
- 4) Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat e VNV-së, në KQZ të jetë deri në përfundim të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë informatike/ ose deri në hapjen e kutive. Pas kalimit të afatit sipas fjalisë së parë të kësaj pike, materiali filmik ruhet në përputhje me ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.
- 5) Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
- 6) Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

**Ilirjana NANO**

**Kryetar**

**Arens ÇELA**

**Anëtar**

**Dritan ÇAKA**

**Anëtar**

**Helga VUKAJ**

**Anëtar**

**Muharrem ÇAKAJ**

**Anëtar**



**Rregullat proceduriale për përdorimin e kamerave regjistruese e monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021**

- 1) Në çdo tavolinë numërimi në VNV të instalohet një kamera në mënyrë të tillë që të realizojë regjistrimin video për vlerësimin e çdo flete votimi.
- 2) Parametrat teknik minimal për kamerën të jenë, rezolucioni jo më i vogël se 3 Mega pixel, shpejtësia e regjistrimit video jo më e vogël se 25 frames për sekondë në rezolucionin e kërkuar.
- 3) Kamera të transmetojë në kohë reale procesin e numërimit të votave në një monitor (ekran) të vendosur përballë vëzhguesve të subjekteve zgjedhore.
- 4) Madhësia e ekranit jo më e vogël se 32 inch. Imazhi i transmetuar në ekran duhet të zërë gjithë hapësirën e ekranit pa konture apo hapësirë boshe. Imazhi i fletës së votimit në ekran të zërë jo më pak se 80% të ekranit.
- 5) Të gjitha imazhet e mara nga kamerat duhet të regjistrohen në formë digjitale gjatë gjithë procesit të numërimit të votave.
- 6) Regjistrimi duhet të kryhet me rezolucionin e transmetimit të imazhit në ekran dhe duhet të krijojë mundësi për kontrollin dhe pamjen e mëvonshme të të gjitha regjistrimeve të kryera.
- 7) Pajisjet e regjistrimit duhet të kryejnë regjistrim të dyfishtë të njëkohshëm në 2 njësi të brendshme të pavarura (Mirror).
- 8) Në çdo imazh të transmetuar dhe të regjistruar të jenë të evidentuar numri i tavolinës në të cilën po numërohen votat dhe numri i grupit të numërimit. Të evidentohet qartë në transmetim dhe regjistrim momenti i fillimit dhe përfundimit të procesit të numërimit të fletëve të votimit për çdo qendër votimi, si dhe të evidentohet qartësisht numri i qendrës së votimit



- 9) Në çdo VNV të instalohet një kamera vrojtimi 360° që të mbulojë të gjithë hapësirën e sallës në VNV. Kamera gjatë gjithë kohës duhet të regjistrojë të gjithë hapësirën pavarësisht nga orientimi i kërkuar në momente të caktuara dhe të mundësojë regjistrimin video dhe audio të sallës.
- 10) Kamera e vrojtimit dhe kamerat e tavolinave gjatë procesit të numërimit duhet të transmetojnë imazhet pranë zyrave qendrore të KQZ në çdo kohë kur paraqitet ndonjë problematikë, ose kur kërkohet nga KQZ me akt të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- 11) Transmetimi i imazheve të bëhet në rrjet të mbyllur, të pavarur dhe me kapacitet të nevojshëm qarkullimi on-line.
- 12) Në ambientet e KQZ duhet të krijohen mundësi monitorimi të njëkohshëm për të paktën 8 (tetë) VNV dhe 8 (tetë) tavolina numërimi.
- 13) Procesi i regjistrimit dhe transmetimit në të gjitha VNV-të duhet të ketë pavarësi nga energjia elektrike për minimumi dy orë.

**Kosto e shërbimit administrativ të këqyrjes dhe vlera financiare e videoregjistrimit**

Video regjistrimi, pavarësisht kohëzgjatjes, do të realizohet në medime (memorie) ruajtje informacioni të jashtëme SSD (solid-state drive), me format video “MP4” ose çdo format tjetër video lehtësisht të lexueshëm, kapacitet standard 2TB dhe me shkëmbim të dhënash të paktën 500 MB për sekondë. Vlera financiare për 1 (një) medium (memorie) ruajtje informacioni të jashtëm SSD (solid-state drive) është 12,500 lek. Në varësi të madhësisë së kapacitetit të informacionit të videoregjistrimeve, do të përcaktohet edhe sasia e medimeve (memorieve) ruajtje informacioni të jashtëm SSD (solid-state drive) .

Kosto e shërbimit administrativ të këqyrjes do të jetë në varësi të orëve të shërbimit që do nevojiten për këqyrjen e informacionit video. Vlera financiare për shërbimin do të jetë 500 lekë ora.



IT Progress  
M02123033S  
Rr.Barrikadave Nd.32,H.3 Njesia  
Administrative Nr.9, 1017 Tirane 1001

## OFERTE

Drejtuar : Komisioni Qendror I Zgjedhjeve

Nr	Pershkrimi I produkteve	Saisa	Cmimi me TVSH	Cmimi Total me TVSH
1	Hard disk I jashtëm 2 terrabyte	1	13,000	13,000
Totali me TVSH				13,000

Ne cmim eshte e perfshire TVSH.

Vlerat e shprehura jane ne Leke.

Administrator  
Erjon Haska







Smart Store  
L52208070A  
Rruga e Barrikadave,  
përballë Gjinnazit "Sami Frashëri"

## OFERTE

Drejtuar : Komisioni Qendror I Zgjedhjeve

Nr	Pershkrimi	Saisa	Cmimi (Lek)	Vlera (Lek)
1	Hard Disk external 2 terra	1	13400	13400
Total				13400

Ne cmim eshte e perfshire TVSH.

Vlerat e shprehura jane ne Leke.

Elvis Hajdari  
SMART STORE  
NUIS: L52208070A  
Rr.Barikada, Tirane

OFERTE EKONOMIKE

Për: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Si me poshte oferta jone teknike – ekonomike sipas kerkesave tuaja:

Nr	Pershkrimi	Saisa	Cmimi (Lek)	Vlera (Lek)
1	Hardisk External 2 TB	1	12,600	12,600
Total me TVSH (LEIK)				12,600

Ju lutem merrni ne konsiderate se:

Cmimet: Jane ne Lek me TVSH te fiksuara gjate gjithë kohes se vlefshmerise se ofertes.



Three handwritten signatures in blue ink, positioned horizontally below the stamp.

PC Store Computers NIPT: L01606034A

Adresa: Rr. e Dibrës 10m mbi kryqëzimin e 9-katësheve, Tiranë

e-mail: [Info@pcstore.al](mailto:Info@pcstore.al) • +355 67 20 73 030 servis: [servis@pcstore.al](mailto:servis@pcstore.al) • +355 67 20 73 032

dryqani: [dryqani@pcstore.al](mailto:dryqani@pcstore.al) • +355 42 221 076